

PROVINCA FRANÇESKANE SHQIPTARE

“ZOJA NUNCIATË”

**Statutet e Rinisë Françeskane Shqiptare**

“Fytyra Jonë”

Shkodër 2006

Statutet e Rinisë Françeskane Shqiptare, **Fytyra Jonë**, janë nxjerrë nga Kushtetuta e Urdhrit Françeskan Shekullar (Terciarët), nga Statutet Ndërkombëtare të RiFra-s dhe janë të përshtatura për realitetin tonë në Shqipëri. Ato përbëhen prej tri pjesëve që dallohen mes tyre dhe e plotësojnë njëra-tjetrën:

**“Mënyra e jetës”** (nenet 1-10), përmban parimet frymëzuese të jetës shpirtërore e apostolike të të rinjve françeskanë;

**“Rregullat organizuese”** (nenet 11-40), që jo vetëm saktëson strukturën juridike të Vëllazërisë RiFra, por në disa raste plotëson e qartëson edhe mënyrën e jetës;

**“Rinia Françeskane në Shqipëri”** (nenet 41-50), përkufizon disa veçori të RiFra-s në Shqipëri, duke e konkretizuar këtë përshtirje në realitetin tonë.

## I.

### Mënyra e jetës

#### **Identiteti e natyra e Rinisë Françeskane**

1. RiFra është një vëllazëri e të rinjve, të cilët, e ndiejnë veten të thirrur prej Shpirtit Shenjt për të bërë një përvojë të jetës së krishterë në dritën e mesazhit të shën Françeskut të Asizit, brenda familjes françeskane. Prej vetë zgjedhjes françeskane për të jetuar në shekull (në botë) si laikë, të rinjtë arrijnë të pjekin thirrjen e tyre në gjirin e familjes së Urdhrit Françeskan Shekullar (Terciarëve), pjesë e të cilit është krejt Rinia Françeskane.
2. Rinia Françeskane e konsideron Rregullën e UFSH-së (Terciarëve), të miratuar prej papës Pali i VI-të, si dokument frymëzues për jetën e tyre, edhe si individ edhe si vëllazëri, duke e pohuar këtë zgjedhje me anë të “Premtimit” (Krah. art. 5).

3. Mënyra e jetës e të Rinjve Françeskanë është Ungjilli: në çdo fjalë të tij, sikurse edhe në çdo njeri, të dinë se takojnë Krishtin Jezus, për këtë arsye duhet të angazhohen me zell, në mënyrë që “të kalojnë prej Ungjillit te jeta konkrete e prej jetës konkrete tek Ungjilli” (krh. Rregulla e UFSH, art. 4).
4. RiFra bën shërbim vëllazëror dhe jep mjetet për të arritur pjekurinë njerëzore, të krishterë dhe françeskane, duke bashkëpunuar në këtë mënyrë “për të bërë të pranishëm shpirtin frymëzues që i bashkon me atin Serafik shën Françeskun në jetën e në misionin e Kishës” (Krh. Rregulla UFSH, art. 1).

### **Angazhime dhe metoda**

5. “Premtimi” është një angazhim i të riut për ta njohur dhe për ta jetuar Ungjillin sipas shembullit të shën Françeskut në gjirin e vëllazërisë së vet, e cila e shoqëron në atë ecje shpirtërore kërkimi e rritjeje.
6. Në përputhje me artikullin 2, për Rininë Françeskane “Mënyra e jetës” është kjo:
  - a) të kërkojë Krishtin, person i gjallë e veprues, në vëllezërit e motrat, në Shkrimin e Shenjtë, në Kishë e në Kremtimet Liturgjike. Ajo fe e shën Françeskut që u tha me këto fjalë: “Asgjë tjetër nuk shoh në këtë botë që është e Birit të Tejetlartë të Hyjit nga ana trupore përveçse Korpin e Gjakun e tij të Shenjtë”, le të jetë për ta frymëzim e orientim për jetën e tyre Eukaristike (Rregulla UFSH).
  - b) të varrosur e të ringjallur bashkë me Krishtin në Pagëzim, i cili i bëri pjesëtarë të gjallë të Kishës, të bëhen dëshmitarë dhe mjet të misionit të tij mes njerëzve, duke e shpallur Krishtin me jetë e me fjalë. Të frymëzuar prej shën Françeskut e, bashkë me të, të thirrur për të riparuar Kishën, të rinjtë françeskanë duhet të angazhohen që të jetojnë në bashkim të plotë me papën, ipeshkvinjtë dhe meshtarët në një dialog të hapur e plot besim për të pasur krijimtari apostolike (Rregulla UFSH, art. 6).
  - c) falë thirrjes së tyre dhe të shtyrë prej forcës ungjillore, mënyrën se si mendojnë e si punojnë t’ia përshtatin asaj mënyre që kishte vetë Krishti, me anë të një ndryshimi të brendshëm që vetë Ungjilli e thërret me emrin “kthimi kah Zoti”, i cili duhet të bëjë çdo ditë, duke e parë se njeriu është i dobët. Në këtë ecje rinuese, Sakramenti i Pajtimit me Zotin (rrëfimi) është

shenjë privilegji prej mëshirës së Hyjit dhe është burim hiresh (Rregulla UFSH, art. 7).

- d) sikurse Jezusi ishte adhurues i vërtetë i Atit, ashtu edhe ata ta kenë lutjen dhe soditjen si shpirt frymëzues të jetës dhe veprimtarisë së tyre. Të marrin pjesë në jetën sakramentare të Kishës, sidomos në Eukaristi, në meshë, dhe t'i bashkohen lutjes liturgjike në njërën prej mënyrave që propozon Kisha, duke i përjetuar misteret e jetës së Krishtit (Rregulla UFSH, art. 8).
- e) Virgjëra Mari, e përvuajtura shërbëtoare e Zotit, e gatshme për fjalën e tij dhe për të gjitha herët që ai e thirri, ajo nderohej prej shën Françeskut me një dashuri të patregueshme e ishte thirrur Pajtoare dhe Avokate e Familjes Françeskane. Të rinjtë françeskanë duhet të kenë një nderim e një dashuri të zjarrtë, duke e imituar gatishmërinë që ajo kishte në mënyrë të pakufi, si edhe t'ia porosisin asaj lutjet me ndërgjegje të pastër me besim të plotë (Rregulla UFSH, art. 9). në mënyrë të veçantë, të lusim Kurorën Françeskane, Rruzaren e Shtatë Mistereve të hareshme.
- f) duke iu bashkuar asaj bindjeje të Krishtit që solli shëlbimin tonë, duke e vendosur vullnetin e vet në vullnetin e Atit, t'i plotësojmë me besnikëri angazhimet e veta që secili ka sipas gjendjes së tij dhe rrethanave të jetës, dhe ta ndjekim Krishtin e varfër e të kryqëzuar, duke e dëshmuar edhe mes vështirësive e përndjekjeve (Rregulla UFSH, art. 10).
- g) Krishti, duke iu besuar Atit, zgjodhi për vete e për Nënë e tij një jetë të varfër e të përvuajtur, e po ashtu duke i vlerësuar me kujdes e me dashuri realitetet e krijuara; në këtë mënyrë (të rinjtë) të kërkojnë të kenë një lidhje sa më të drejtë me të mirat tokësore, kur i lënë ose kur i përdorin ato, duke i thjeshtësuar kërkesat e tyre materiale; të jenë të vetëdijshëm të jenë, sipas Ungjillit, përdorues të të mirave të tyre për të mirën e bijve të Zotit. E kështu, me shpirtin e “Lumturive”, të përpiqen për të pastruar zemrën prej çdo tendence lakmie për pushtet dhe sundim, e të jenë “shtegtarë e të huaj” në rrugën që na çon te shtëpia e Atit.
- h) si dëshmitarë të të mirave të ardhshme dhe të angazhuara në atë thirrje që e përfaqon në pastërtinë e zemrës, të bëhen të lirë në dashuri ndaj Zotit e ndaj vëllezërve (Rregulla UFSH, art 12).
- i) sikurse Hyji Atë sheh në çdo njeri trajtën e Birit të vet, i parëlindur mes shumë vëllezërve, ashtu t'i pranojnë të gjithë njerëzit me shpirt të përvuajtur dhe të sjellshëm, si dhuratë prej Zotit e si përngjasim i Krishtit. Vetë kuptimi për të qenë një vëllazëri, ka për ti bërë të jenë të gëzuar kur të vihen të barabartë me gjithë njerëzit, veçanërisht me më të vegjlit, për të cilët kanë

tu përpjekur për të krijuar kondita të një jete të denjë për krijesat e shëlbuaara prej Krishtit (Rregulla UFSH, art. 13).

- j) të thirrur, bashkë me gjithë njerëzit vullnetmirë, për të ndërtuar një botë sa ma vëllazërore dhe më ungjillore, që të realizohet Mbretëria e Zotit të vetëdijshëm se “kushdo e ndjek Krishtin, Njeriun e përkryer, ai bëhet edhe më shumë njeri”, t’i ushtrojë me kompetencë ato përgjegjësi që kanë e me shpirtin e krishterë të shërbimit (Rregulla UFSH, art 14).
- k) të jenë të pranishëm me dëshminë e jetës së tyre njerëzore dhe me nisma të guximshme, si individuale po ashtu edhe të përbashkëta, në promovimin e drejtësisë e veçanërisht në fushën e jetës publike, duke u angazhuar me zgjedhje konkrete e që i përputhen fesë së tyre (Rregulla UFSH, art. 15).
- l) ta konsiderojnë punën e tyre si dhuratë e si pjesëmarrje të krijimit mbarë, të shëlbimit që vjen prej Zotit dhe në shërbim të bashkësisë së krishterë (Rregulla UFSH, art. 16).
- m) në familjet e tyre ta përjetojnë shpirtin françeskan të paqes, besnikërisë e respektit për jetën, duke u angazhuar që ta bëjnë familjen e shenjtë të një bote që rinohet nga Krishti (Rregulla UFSH, art. 17).
- n) si përçues të paqes dhe duke ditur se kjo ndërtohet vazhdimisht, të kërkojnë ato rrugë bashkimi e vëllazërimi që arrihet me anë të dialogut, duke besuar në praninë e farës hyjnore e cila është brenda njeriut e duke besuar në pushtetin transformues të dashurisë e të faljes. Lajmëtarë të “haresë së përsosur”, në çdo rrethanë të angazhohen për t’ua sjellë të tjerëve gëzimin dhe shpresën (Rregullën UFSH, art. 19).
- o) të kenë respekt për çdo krijesë, frymore e jofrymore, që “e ka kuptimin te Zoti i Tejetlartë“, e të përpiqen të kalojnë prej tundimit për të shfrytëzuar tek ai koncept françeskan i vëllazërisë universale.

7. Për të realizuar plotësisht këtë mënyrë jete, sipas vetë nevojave të botës së të rinjve dhe të pedagogjisë me ta, të rinjtë françeskane:

- a) ta jetojnë vëllazërinë si shenjë të dukshme të Kishës, bashkësi dashurie, ambient i përzgjedhur në të cilin zhvillohet kuptimi i Kishës, thirrja e krishterë e ajo françeskane, po ashtu ta jetojnë edhe si një vend ku në mënyrë të natyrshme merr shpirt jeta apostolike e pjesëtareve të saj.
- b) të bëjnë pjesë plotësisht, në mënyrë aktive e vepruese, në jetën e Kishës lokale/dioqezane, duke mbetur të hapur përballë të gjitha perspektivave ministeriale e pastorale.

- c) ta shtojnë dialogun e bashkëpunimin si me Vëllazëritë françeskane po ashtu edhe me grupet e tjera kishtare, me qëllim që anasjelltas të pasurohen sa më shumë e të kryejnë shërbim të frytshëm në Kishë e në shoqëri.
  - d) t`u përgjigjen me zemërgjerësi udhëzimeve që vëllazëria kombëtare e rajonale ofrojnë për formim me anë të teksteve, kampeve verore, kurseve përditësuese, tërheqjeve shpirtërore, momenteve të lutjes, verifikimeve të jetës dhe nismave të tilla të kryera me atë qëllim;
  - e) të përfshijnë në veprimtari baritore të gjitha mjetet e përshtatshme për një ungjillëzim të ri e të frytshëm (mjetet e komunikimit shoqëror e artistik).
8. Vëllazëria rinore françeskane promovon takimet që bëhen për përgatitjen dhe formimin e të rinjve dhe të fejuarve drejt jetës sakramentare të martesës.
  9. Me kujdes të veçantë të rinjtë të shkojnë drejt punëve vullnetare, që bëhen për të siguruar një shërbim njerëzor, të përgjegjshëm e të painteres, ndaj vëllezërve, veçanërisht në ambientin e territorit të vet e në perspektivën e pajtimit si brenda vendit po ashtu edhe jashtë tij.
  10. Interesi i Rinisë Françeskane është i drejtuar edhe te momentet argëtuese, të cilat janë një dëshmi e mëtejshme e asaj përvoje të gëzueshme të jetës.

## II.

### Normat organizuese

11. Rinia françeskane jeton dhe vepron e nyjzuar në vëllazëri e nivele të ndryshme:
  - lokale, krahinore dhe kombëtare;
  - të lidhura dhe të koordinuara mes tyre si dhe të projektuara në bashkëthurjen ndërkombëtare.
12. Quhen formalisht të krijuara ato vëllazëri që duke pasur një numër të mjaftueshëm të rinjsh që kanë bërë “Premtimin”, kanë marrë njohjen me shkrim nga organi superior i RiFra-s përkatëse në mirëkuptim me vëllazërinë UFSH nëse ekziston në vend, ose me këshillin krahinor UFSH.

## **Përkatësia**

13. Mund të bëjnë pjesë në një vëllazëri të rinjtë që kanë mbushur të 17-at dhe që mundësisht nuk i kanë kaluar të 30-at. Kufizimi i fundit nuk aplikohet për drejtuesit kombëtarë e krahinorë në detyrë.
14. Të rinjtë që kanë mbushur të tridhjetat vazhdojnë eksperiencën e tyre të jetës ungjillore në Urdhrin Françeskan Shekullar, ose në mënyra të tjera të jetës së krishterë. U rekomandohet një zgjedhje e tillë edhe të martuarve.
15. Kandidatët bëjnë një përgatitje prej të paktën gjashtë muaj përpara “Premtimit” pas të cilit bëhen anëtarë efektivë të Rinisë Françeskane. Pranimi në “Premtim” vendoset nga këshilli i vëllazërisë lokale.
16. Festa e “Premtimit” në të cilin të rinjtë pranojnë ose përjetojnë çdo vit angazhimin e jetës ungjillore në RiFra, kremtohet me shumë solemnitet. Në raste të tilla mund të bëhet edhe dorëzimi i një shenje françeskane, më i pëlqyeshëm do të ishte një *Tau*.

## **Bashkëpunimi me UFSH-në (Terciarët)**

17. Për të favorizuar një bashkim më të ngushtë me UFSH-në këshillet e RiFra-s të çdo shkalle emërojnë një përfaqësues të posaçëm, preferohet që të kenë bërë kushtet, pranë vëllazërisë së UFSH-së dhe i kërkojnë UFSH-së një delegat të saj in pranë vëllazërisë rinore. I deleguari i UFSH-së ka të drejtë vote në këshillin e RiFra-s në të cilin merr pjesë.

## **Organet.**

18. Organet nëpërmjet të cilave vëllazëria shpreh funksionimin vetjak janë: Asambleja, Këshilli, Presidenti dhe për sa i përket anës shpirtërore Asistenti. Funksionimi i organeve të tilla rregullohet nga norma specifike.

## Asambleja

19. Asambleja e quajtur edhe Kongresi, ose Kapitulli është organi përfaqësues bazë, me fuqi legjislative dhe vendimore. Në rang kombëtar thirret të paktën pesëdhjetë ditë përpara, në rang krahinor të paktën njëzet ditë dhe në rang lokal me të paktën dhjetë ditë.

Asambleja kombëtare përbëhet nga këshilltarët kombëtarë në detyrë përveç Presidentëve dhe Asistentëve krahinorë, dhe nga një i zgjedhur nga Asambleja krahinore për çdo dhjetë vëllazëri lokale të krahinës për të përfaqësuar.

Asambleja krahinore është e formuar nga këshilltarët krahinorë në detyrë si dhe nga gjithë Presidentët dhe Asistentët lokalë. Nëse shihet e nevojshme edhe nga një numër i përshtatshëm përfaqësuesish të përcaktuar nga këshilli krahinorë dhe të zgjedhur nga baza.

Asambleja lokale është e formuar nga të gjithë anëtarët efektivë të vëllazërisë, plus Asistentin e RiFra-s dhe të dërguarin e UFSH-së.

20. Asambleja kombëtare mblidhet rregullisht të paktën një herë në tre vjet, ajo krahinore të paktën një herë në vit dhe ajo lokale të paktën dy herë në muaj. Në mënyrë të jashtëzakonshme Asambleja e çfarëdo shkalle mblidhet çdo herë që këshilli përkatës mban të nevojshme, ose kur një e treta e anëtarëve të Asamblesë bën kërkesë me një propozim me shkrim.

21. Asambleja ka detyrë, në përputhje me udhëzimet dhe vendimet e Asamblesë së shkallës superiore:

- a) të merret me studimin e problemeve me rëndësi mjaft të madhe shpirtërore, sociale dhe kohore të vëllazërisë dhe të marrë vendime në lidhje me to.
- b) të programojë aktivitetet e ndryshme.
- c) të procedojë në emërimin e presidentëve dhe këshilltarëve përkatës sipas rregullave të dhëna më poshtë.
- d) të përcaktojë kontributet për financimin e aktiviteteve të ndryshme.

## Këshilli

22. Këshilli është organi ekzekutiv i vendimeve dhe udhëzimeve të Asamblesë së saj dhe asaj të shkallës superiore dhe siguron funksionimin e rregullt të vëllazërisë. Në mënyrë të veçantë detyra e tij është:
- a) t`u japë jetë dhe të koordinojë aktivitetet e vëllazërisë.
  - b) të organizojë kurse rikualifikimi, studimi, ushtrime shpirtërore, takime, tubime dhe iniciativa të njëjta.
  - c) të kujdeset për formimin e drejtuesve dhe animatorëve.
  - d) të interesohet për shtypin dhe mjetet e tjera të komunikimit social.
  - e) të diskutojë dhe aprovojë relacionin e përvitshëm përgatitur nga Presidenti.
  - f) të nxisë dhe të stimulojë këshillat e shkallëve inferiore.
  - g) të mbajë gjallë marrëdhëniet dhe të rrisë vazhdimisht bashkëpunimin me gjithë Familjen Françeskane, veçanërisht me UFSH-në me programe dhe iniciativa të përbashkëta në lloj, në rrethin e kishës lokale.
  - h) të nxisë dhe të kujdeset për shoqatat “Araldini” të vegjlit në bashkëpunim me UFSH-në, përveç veprave misionare.
  - i) të zgjedhë brenda gjashtë muajsh dhe për periudhën e mbarimit të afatit të këshillit një President të ri atëherë kur ai në detyrë nuk mund të çojë përpara detyrën për çdo lloj arsyeje.
  - l) të emërojë një këshilltar tjetër gjithmonë deri në mbarimin e afatit të këshillit në detyrë kur dikush tërhiqet për çdo lloj arsyeje.
  - m) të emërojë këshilltarë të tjerë, aq sa numri i tyre të mos kalojë një të tretën e numrit të përgjithshëm.
  - n) të deklarojë të rënë nga detyra Presidentin, ose Këshilltarin që pa arsye të forta nuk ka qenë i pranishëm, në nivel kombëtar për dy herë rrallazi, në nivel krahinor për tre herë rrallazi.
23. Këshilli kombëtarë është i formuar nga Presidenti dhe pesë anëtarë të tjerë plus Asistentin. Këshilli krahinor dhe lokal përbëhen nga Presidenti dhe nga një numër anëtarësh i përshtatshëm për madhësinë dhe aktivitetin e vëllazërisë, plus Asistentin e së njëjtës shkallë. Është pranuar emërimi, nga ana e këshillave përkatëse, i një sekretarie për kryerjen e praktikave të zakonshme. Këshilltarëve u është besuar gradimi dhe kujdesi i sektorëve të ndryshëm të aktiviteteve të vëllazërisë.
24. Këshilli kombëtar mblidhet të paktën dy herë në vit; ai krahinor të paktën tre herë dhe ai lokal të paktën një herë në muaj.

25. Këshilltarët kombëtarë bëjnë pjesë me të drejtë në këshillat e shkallës inferiore me seli të vetën dhe të drejtë vote. Kështu kuptohet për këshilltarët krahinorë.
26. Këshillat e shkallës superiore kanë juridiksion mbi ato inferiore për zgjedhjen e çështjeve që dalin herë pas here.

## **Presidenti**

27. Presidenti është përgjegjësi i gjithë lëvizjes së vëllazërisë, të zyrave të ndryshme dhe detyrave për sa i takon funksionalitetit të tij. Ai përfaqëson vëllazërinë dhe përkujdeset për zbatimin e udhëzimeve dhe të Asambleve dhe këshillit. Ndihmohet në gjithçka nga një zëvendës, i zgjedhur mes këshilltarëve, i cili e zëvendëson gjatë mungesës së tij, me përjashtim të asaj që është përcaktuar në paragrafin 22/i.

## **Asistenti shpirtëror.**

28. Në shenjë bashkimi me gjithë Familjen Françeskane këshilli i RiFra-s i kërkon eprorëve kompetentë një Asistent që të kujdeset nga ana shpirtërore për çdo njërin në veçanti dhe gjithë vëllazërinë në përgjithësi. Ai mbron dhe ushqen kuptimin kishtar dhe karizmën françeskane. Favorizon formimin bazë dhe të veçantë përveç nxitjes së përgjithshme të gjithë vëllazërisë. Ai bën pjesë me të drejtë në Asambletë dhe këshillat e shkallës së tij.

Në nivel kombëtar dhe rajonal nëse është e mundshme bashkë me Asistentin bëjnë pjesë në këshilla edhe të tjerë rregulltarë françeskanë, megjithatë jo më shumë se tre që të merren në mënyrë të veçantë me RiFra-në në vendet ku nuk janë prezent rregulltarë françeskanë, detyra e Asistentit u besohet meshtarëve ose rregulltarëve të tjerë.

## **Zgjedhjet**

29. Emërimi në detyrë i Presidentit dhe këshilltarit të çfarëdo shkalle bëhet nëpërmjet zgjedhjeve dhe këto kryhen me vota të fshehta.

30. Për zgjedhjen e Presidentit dhe zëvendës Presidentit të çfarëdo niveli kërkohet shumica absolute e votave të të pranishmëve në shqyrtimin e parë dhe të dytë të votave. Ndërsa në të tretin procedohet për balotazhin mes dy personave që nga votimi i fundit kanë marrë më shumë vota. Për zgjedhjen e këshilltarit të çfarëdo shkalle është e mjaftueshme shumica relative e votave të të pranishmëve mjaft që votuesit të mos jenë më pak se një e treta.
31. Me votimin e parë zgjidhen këshilltarët; mes të cilëve me një votim pasues zgjidhet Presidenti; me një të tretën, zëvendës Presidenti, gjithmonë mes të zgjedhurve. Një kopje e dokumentit deklarues të zgjedhjeve të kryera, e firmosur nga Presidenti dhe sekretari i Asamblesë së zgjedhur, i dërgohet këshillit të shkallës superiore.
32. Asamblatë e zgjedhura që janë të vlefshme përveç vënies në jetë të rregullave ekzistuese, duhet të drejtohen nga Presidenti i shkallës superiore, ose nga një i dërguar i tij, në prani të Asistentit të të njëjtit nivel. Asamblatë e zgjedhura kombëtare drejtohen nga Presidentët kombëtarë të UFSH-së (ose të deleguarit e tyre).
33. Presidenti dhe këshilltarët kombëtarë dhe krahinorë qëndrojnë në detyrë për tre vjet, ata lokalë dy vjet. Presidentët kombëtarë dhe rajonalë mund të zgjidhen vetëm një herë të vetme menjëherë pas zgjedhjes së parë.
34. Presidentët kombëtarë dhe rajonalë të jenë persona që kanë bërë kushtet.
35. Në zgjedhjen e Presidentit dhe këshilltarëve lokalë, kanë të drejtë vote me Asistentin të gjithë anëtarët e përhershëm të vëllazërisë. Në zgjedhjet në nivel rajonal kanë të drejtë vote, përveç Asistentit dhe bashkëpunëtorëve të tij (paragrafi 28), të gjithë anëtarët e asamblesë rajonale. Në të njëjtë mënyrë kryhen në mënyrë analoge në nivel kombëtar.

### **Ndërdëgjesa (Asambleja mes dëgjesa të ndryshme)**

36. Përderisa ekzistojnë “Dëgjesat”, funksionon edhe një asamble dhe një këshill “mes dëgjesave të ndryshme” për çdo nivel.
37. Asambleja kombëtare “mes dëgjesave të ndryshme” është fytyra e Asambleve të të gjitha dëgjesave. Ajo mbledhet një herë në tre vjet dhe kryesohet nga Presidenti i këshillit mes dëgjesave të ndryshme (artikulli 38).

Përveç detyrave të paraqitura në artikullin 21 është në kompetencën e saj aprovimi, rikualifikimi dhe interpretimi i rregullave ekzistuese, me përjashtim të ratifikimit të superiorëve kompetentë. Në **Asamblenë kombëtare** mes dëgjesave të ndryshme marrin pjesë këshillet kombëtare, Presidentët dhe Asistentët rajonalë të RiFra-së (ose të dërguarit e tyre), një numër i përshtatshëm anëtarësh të RiFra-së të përcaktuar nga këshilli kombëtar mes dëgjesave të ndryshme dhe të zgjedhur nga baza në rajone të posaçëm, përveç Presidentëve dhe Asistentëve kombëtarë të UFSH-së (ose të dërguarit e tyre). Në **Asamblenë rajonale** ndërregulltare marrin pjesë këshillet rajonale, Presidentë dhe Asistentë lokalë (ose të dërguarit e tyre) përveç presidentëve dhe Asistentëve rajonalë të UFSH-së (ose të dërguarve të tyre).

38. Këshilli kombëtar mes dëgjesave të ndryshme përbëhet nga Presidenti dhe zëvendës Presidenti kombëtar, nga Asistentët kombëtarë dhe nga një i dërguar i këshillit kombëtar mes dëgjesave të ndryshme i Urdhrit Françeskan Shekullar. Drejtohet dhe mbështetet në radhë vjetore nga Presidentët dhe Asistentët e “Dëgjesave” të ndryshme. Detyra e tij është:
- a) të nxisë dhe koordinojë punën e këshilleve kombëtare
  - b) të përgatisë, thërrasë dhe nxisë Asamblenë kombëtare mes dëgjesave të ndryshme.
  - c) t`u tregojë këshillit ndërkombëtar të UFSH-së dhe organeve të tjera të mundshme përfaqësuesit e tij.
  - d) në raste të veçanta të bëjë përjashtime nga rregullat ekzistuese.
39. Këshillet ndërregulltare të shkallës më të ulët përbëhen dhe funksionojnë në mënyrë të ngjashme me ato kombëtare.

## **Kontributet**

40. Për shpenzimet e përfshira në jetën dhe aktivitetin e vëllazërisë, në shenjë bashkimi dhe solidariteti, të gjithë ofrojnë një kontribut në masën e vendosur nga Asambletë e shkallëve të ndryshme.

### III.

## Rinia Françeskane në Shqipëri

41. Të jesh Rini Françeskane, do të thotë, të jetosh kohën e rinisë si na mëson Krishti nëpërmjet Ungjillit dhe siç na udhëzon Kisha: me anë të një jete të pastër e aktive në një formë vëllazërore.
42. RiFra në Shqipëri u fillua e drejtohet nga Urdhri i Fretërve Minorë, për sa i përket asistencës shpirtërore; ndërsa, për sa i përket drejtimit dhe zgjidhjes së çdo problemi, ka si pikë referimi Ministrin e Urdhrit Françeskan Shekullar OFM në Shqipëri.
43. Formimi i Rinisë Françeskane në Shqipëri bëhet në tri etapa:
  - 1) Përvoja në një Grup Rinor të Famullisë, të paktën një vit;
  - 2) Pranimi në RiFra dhe Formimi sipas Përshpirtërisë Françeskane;
  - 3) Premtimi i të riut për një jetë ungjillore në gjirin e Vëllazërisë RiFra, akt, i cili shpreh vullnetin e lirë të çdo të riu që do të përqafojë këtë mënyrë jete.
44. Rinia Françeskane bën pjesë në Kishën Katolike dhe ajo përbëhet nga të rinj që jetojnë një jetë sakramentare dhe besojnë ashtu si na mëson Zoti me anë të shërbëtorëve të tij ipeshkvinjte e meshtarët. Ajo që beson Kisha Katolike është bazë për jetën e RiFra-s, për këtë arsye duhet përvoja në një grup famullie.
45. Sikurse shën Françesku u jep fretërve Ungjillin si Rregullë = Mënyrë jete, po ashtu RiFra, nuk ka asnjë detyrim tjetër, në krahasim me të krishterët e tjerë, veçse, të jetojë sipas Ungjillit. Kjo mënyrë jete, për RiFra-në, arrihet me anë të përshpirtërisë françeskane. Kjo është arsyeja për formimin si RiFra.
46. Veçoria e RiFra-s, qëndron në faktin se i riu, me anë të Premtimit, si akt i lirë personal, bëhet pjesëtar i Vëllazërisë RiFra me të gjitha të drejtat e detyrimet që tregohen në Statutet e Rinisë Françeskane, të nxjerra nga Kushtetuta e UFSH-së (Terciarëve) si dhe nga Statutet e RiFra-së ndërkombëtare, të përshtatura për ne.
47. Sikurse në kohën e shën Françeskut, françeskanët shekullarë (Terciarët), dalloheshin si të tillë, duke i rënë mohit të drejtës për vetëmbrojtje, mbajtjes së armëve dhe hakmarrjes, për të treguar shpirtin françeskan të paqes dhe vëllazërimit, po ashtu Rinia Françeskane Shqiptare, duke parë se është aktuale për vendin tonë një gjë e

tillë, nuk përdor as armë, as mjete vdekjeprurëse si droga apo të tjera si ajo. Gjithashtu, nuk kërkon të shkaktojë mosmarrëveshje, grindje apo vrasje, e si rrjedhojë, as hakmarrjen e as gjakmarrjen.

48. Të rinjtë françeskanë, edhe pse kanë një autonomi të veten, duhet të angazhohen në jetën e famullisë e të dioqezës, duke iu bindur meshtarëve famullitarë e ipeshkvijve, për sa u përket punëve baritore që ato kryejnë, e duke bashkëpunuar me ta, të cilët janë prijësit tanë në fe e në jetën e Kishës.
49. Rinia Françeskane në Shqipëri ka si model të vetin FAMILJEN, do të thotë, të kujdesesh që të rinjtë të marrin ato vlera shpirtërore e shoqërore, të krishtera e njerëzore dhe t'i përçojnë ato me një frymë familjare në shoqërinë e tyre dhe në mbarë shoqërinë njerëzore.
50. Përballë fenomenit të emigrimit dhe migrimit të familjeve shqiptare Rinia Françeskane Shqiptare, me organizimin e saj brenda dhe jashtë vendit, paraqitet si mundësi për takime dhe formim mes të rinjve, si edhe për zhvillimin e shumë veprimtarive në të mirën e çdo njeriu, pa dallime krahinore, kulturore, gjuhe, apo kombësie.

**Shënim:** teksti i Statuteve të përgjithshme të RiFra-s është marrë nga [www.gifra.org](http://www.gifra.org), e më pas u përkthye në shqip duke shtuar disa pika që janë më afër realitetit tonë. Ky tekst u propozohet për korrigjim dhe miratim autoriteteve kompetente.

Shtator 2006

Frat Gjon Kalaj, ofm, diakon  
*Asistent i Pastoralit Rinor Françeskan*